Nr .76Prot

Tiranë, më 08.10.2020

VENDIM
I
BORDIT DREJTUES TË

SHKOLLËS SË DREJTORËVE TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 11 të Vendimit Nr. 540, datë 19.9.2018, "Për organizimin dhe funksionimin e Shkollës së Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar dhe mënyrën e trajnimit e të certifikimit të tyre" dhe nenit 5.4 të Statutit të Shkollës së Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar, Bordi Drejtues vendosi:

1. Miratimin e Rregullores të "Programit të Trajnimit për Zhvillim Profesional të Vazhdueshëm" ("**Rregullorja**").
2. Miratimin e ndryshimeve të mësipërme.
3. Autorizimin e Kryetarit të Bordit Drejtues për nënshkrimin e tekstit të konsoliduar të Rregullores.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarët e Bordit Drejtues të Shkollës së Drejtorëve të IAPU.

Rezana Vrapi – Kryetar

Aleksandër Sarapuli – Nënkryetar

Martin Mata – Anëtar

Yehudit Shalvi – Anëtar

Gerti Janaqi – Anëtar

Gerti Janaqi

Adresa: Bulevardi "Zhan d'Ark", Nr. 23, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 220 9185 / E-mail: info@csl.edu.al / Web: www.csl.edu.al

RREGULLORE
PËR
PROGRAMIN E TRAJNIMIT PËR ZHVILLIM PROFESIONAL TË VAZHDUESHËM

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i rregullores

Kjo Rregullore synon të përcaktojë procedurat dhe rregullat për mirë funksionimin e programit të trajnimit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Dokumenti përfshin gjithashtu proceset kryesore të programit.
Elementet kryesore që janë objekt i kësaj rregullore janë si më poshtë:
Rregullat për procesin e aplikimit dhe rekrutimit të trajnerëve për programin e trajnimit për zhvillim profesional të vazhdueshëm.

a. Kriteret për zgjedhjen e trajnerëve. Trajnerët mund të jenë individë, universitete dhe/ose agjenci që do të ofrojnë trajnime për programin e trajnimit për zhvillim professional të vazhdueshëm.
b. Procesi i aplikimit të mësuesve dhe drejtorëve të shkollave, të cilët janë të interesuar për të marrë pjesë në programin e trajnimit për zhvillim profesional të vazhdueshëm.
c. Zbatimi i programit të trajnimit për zhvillim profesional të vazhdueshëm. Procesi i certifikimit të pjesëmarrësve të programit të trajnimit për zhvillim profesional tëvazhdueshëm.
d. Çmimet e shërbimeve.

Neni 2
Prezantimi i programit të trajnimit për zhvillim profesional të vazhdueshëm

1. Programi i trajnimit për zhvillim profesional të vazhdueshëm është një program fakultativ, i konceptuar për tu shërbyer të gjitha grupeve të mësuesve, drejtorëve dhe zv/drejtorëve në shkollat e arsimit parauniversitar.

Adresa: Bulevardi "Zhan d'Ark", Nr. 23, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 220 9185 / E-mail: info@csl.edu.al / Web: www.csl.edu.al

Ky program përfshin tema për mësuesit që sapo kanë filluar karrierën e tyre, drejtuesit e departamenteve që aspirojnë të jenë drejtorë dhe drejtorë me përvojë që duan të rriten profesionalisht.

2. Programi përmban katër (4) module, duke i dhënë mundësinë e rritjes profesionale sipas nevojave të gjithë mësuesve dhe drejtuesve të shkollës. Modulet përfshijnë katër ndërhyrje të tilla si:

a. Horizonte të reja - Program për mësuesit që janë në fillim të karrierës së tyre.
b. Të mësosh të udhëheqësh - Programi për menaxhimin e nivelit të mesëm, ku përfshihen mësues, drejtues të departamenteve, ose aspirantë për të qenë drejtorë
c. Programi i drejtimit (lidershipit) për drejtorë në detyrë - Një program hyrës për drejtorët me një përvojë 1-3 vjet në udhëheqje.
d. Nga mirë në të shkëlqyer - Programi i udhëheqjes për drejtorë me përvojë të gjatë pune.

3.Një trajnim përfshin gjithsej 18 orë dhe kjo kohë është e ndarë në seanca në auditor dhe orë praktike.

4.Programi i trajnimit për zhvillim profesional të vazhdueshëm ka një grup modulesh të akredituara që zhvillohen nga trajnerët e zgjedhur. Përveç kësaj, Shkolla e Drejtorëve vazhdimisht organizon vlerësime të nevojave për ndërtimin e kapaciteteve të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave me qëllimin që të krijojë module të posaçme për të adresuar këto nevoja.

5. Modulet janë të organizuara sipas temave dhe materialeve të rëna dakord më parë.

6. Kapaciteti minimal i personave në një trajnim është 15 dhe maksimumi është 30 persona.

KREU II

RREGULLAT DHE KRITERET PËR PROCESIN E APLIKIMIT DHE TË REKRUTIMIT TË TRAJNERËVE PËR PROGRAMIN E TRAJNIMIT PËR ZHVILLIM PROFESIONAL TË VAZHDUESHËM.

Neni 3
Rregullat për procesin e aplikimit dhe të rekrutimit të trajnerëve për programin e trajnimit për zhvillim profesional të vazhdueshëm.

1. Për të zgjedhur trajnerët që do të ofrojnë trajnimet, Shkolla e Drejtorëve do të hap një thirrje për aplikime për personat e interesuar, universitete ose subjekte të licencuar që do të zhvillojnë modulet dhe do të ofrojnë trajnimet. Shkolla e Drejtorëve do të përcaktojë termat e referencës dhe afatet e thirrjes. Qëllimi i këtij procesi është të mundësojë

identifikimin e trajnerëve më të mirë në treg dhe të ndërtojë një program me cilësi të lartë.
2. Thirrja e interesit do të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a. Përshkrimin e programit të trajnimit për zhvillim profesional të vazhdueshëm.
b. Përshkrimin e qëllimit dhe objektivave të thirrjes.
c. Përshkrimin e kritereve të strukturës së trajnimit, orëve të trajnimit dhe metodologjisë.
d. Njohuritë dhe aftësitë që pjesëmarrësit duhet të fitojnë nga trajnimi.
e. Kriteret për trajnerët të cilët potencialisht do të ofrojnë kursin e trajnimit.
f. Kriteret për propozimet financiare të trajnimit.
g. Formulari i aplikimit.

3.Të gjithë aplikantët e interesuar duhet të aplikojnë brenda afateve të kërkuara dhe duke respektuar të gjitha kriteret e përcaktuara në dokumentin e Kushteve të Referencës.

Neni 4
Kriteret për zgjedhjen e trajnerëve, universiteteve dhe agjencive që do të ofrojnë trajnime për programin e zhvillimit profesional të vazhdueshëm.

1. Përzgjedhja e trajnerëve ose subjektit të trajnimit do të ndodhë përmes një procesi konkurrues bazuar në dokumentet që ata kanë dërguar në procesin e aplikimit, siç janë: forma e aplikimit, CV dhe oferta financiare.
2. Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet nga një komision prej tre stafesh të Shkollës së Drejtorëve, duke përfshirë një staf programi, një staf financë / administratë dhe një staf monitorimi dhe vlerësimi. Vlerësimi do të bëhet duke marrë parasysh aspekte programatike dhe financiare. Vlerësimi do të marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

a. Cilësia e programit (përshkrimi i propozimit, objektivat, metodologjia dhe format e vlerësimit) - 40%
b. Përvoja e trajnerit - 30%
c. Oferta financiare - 30%

3. Kriteret që duhet të ketë një trajner për të qenë pjesë e programit të trajnimit për zhvillim profesional të vazhdueshëm janë si më poshtë:

a. Të jenë lektorë ose studiues të fushës, mësues të mëparshëm dhe drejtorë me ekspertizë në fushat e kërkuara.
b. Trajnerët mund të jenë vendas ose të huaj. Përfshirja e trajnerëve të huaj do të bëhet në rastet kur mungon ekspertiza lokale, ose kur kjo përfshirje sjell një vlerë të shtuar për programin e trajnimit.

c. Të ketë ekspertizë në fushën e arsimit, udhëheqjes (lidership) dhe menaxhimit të shkollës.
d. Të ketë të paktën pesë (5) vjet përvojë në fushat e përmendura më lart.
e. Të ketë përvojë në ofrimin e trajnimeve.
f. Të zhvillojë një modul të dedikuar për Shkollën e Drejtorëve, të cilat nuk janë përdorur dhe nuk mund të përdoren në organizata ose agjenci të tjera për përfitime pa lejen me shkrim të Shkollës së Drejtorëve.
g. Ofruesi do nënshkruajë një kontratë ku pranon që punët e bëra nën drejtimin dhe kontrollin e Shkollës së Drejtorëve do të jenë ekskluzive pronë e Shkollës së Drejtorëve.
h. Në rast se ofruesi përfshin në aplikim punë te krijuara më parë nga ndonjë palë e tretë, ofruesi duhet të informojë më parë Shkollën e Drejtorëve për kushtet përkatëse të licencimit dhe të marrë miratimin paraprak nga Shkolla e Drejtorëve. Në këtë rast, ofruesi garanton transferimin e çdo licence të marrë nga palët e treta.
i. Shkolla e Drejtorëve është pronar i çdo produkti që vjen si rezultat i zbatimit të kontratës.
j. Produktet e prodhuara nuk mund të ndahen, publikohen, përdoren dhe shpërndahen nga ofruesi pa pëlqimin paraprak të Shkollës së Drejtorëve. Këto të drejta do të vazhdojnë edhe pas përfundimit të kësaj marrëdhënie.

5. Përgjegjësitë e trajnerëve të zgjedhur në program janë si më poshtë:
a. Të sigurojë të gjithë paketën e trajnimit në kohë dhe me cilësi të lartë (përfshirë prezantime, fletëpalosje, materiale mësimore, video dhe metoda të tjera që do të përdoren në trajnim).
b. Të sigurojë trajnimin në kohën e dakordësuar me Shkollën e Drejtorëve.
c. Të organizojë një trajnim me cilësi të lartë duke respektuar me rigorozitet programin dhe kushtet e kontratës.
d. Të ndjekë punën e pjesëmarrësve gjatë orëve të vetë-studimit, projekteve etj.
e. Të kryejë vlerësimin e pjesëmarrësve në trajnim bazuar në kushtin e akreditimit.
f. Përgatitja e një raporti përfundimtar për trajnimin.

6.Trajneri duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme:
a. Të ketë ide inovative dhe aftësi profesionale krijuese.
b. Të ketë qëndrim etik dhe aftësi të shkëlqyera komunikimi.
c. Të tregojë korrektësi në të gjitha detyrat.
d. Të ketë gatishmëri për të bashkëpunuar me kolegët dhe pjesëmarrësit.
e. Të gëzojë aftësi profesionale për të përcjellë qartë informacionin e programit të trajnimit.

Adresa: Bulevardi "Zhan d'Ark", Nr. 23, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 220 9185 / E-mail: info@csl.edu.al / Web: www.csl.edu.al

KREU III
APLIKIMI PËR PJESËMARRJE NË PROGRAM

Neni 5
Procesi i aplikimit të mësuesve dhe drejtorëve të shkollave të interesuara për të marrë pjesë në programin e trajnimit për zhvillim profesional të vazhdueshëm.

1. Në programin e trajnimit për zhvillim profesional të vazhdueshëm mund të regjistrohen mësuesit dhe drejtuesit e shkollave që duan të investojnë në zhvillimin e tyre përmes trajnimeve të akredituara dhe që janë të gatshëm të regjistrohen në këto kurse. (Aplikantët mund të jenë mësues që janë në fillimin e karrierës së tyre, drejtues departamentesh që aspirojnë të jenë drejtorë dhe drejtorë që duan të rriten më tej profesionalisht).
2. Personat e interesuar mund të aplikojnë përmes këtij procesi:

a. Aplikanti duhet të plotësojë aplikimin online duke specifikuar të dhenat e tij te tilla si; emër, mbiemër, temën në të cilën është interesuar të marrë pjesë dhe kohen e trajnimit.
b. Aplikanti duhet të sigurojë një kopje të kartës së identitetit ose pasaportës së tij.
c. Aplikanti duhet të sigurojë deklaratën e pagesës për trajnimin. *Shënim i Rëndësishëm:* Pagesa nuk bëhet në momentin e aplikimit në internet, por bëhet vetëm pasi stafi i Shkollës së Drejtorëve i jep konfirmimin për trajnim pjesëmarrësit.

3. Aplikimi në internet do të bëhet përmes platformës së Shkollës së Drejtorëve. Nëse aplikanti nuk është në gjendje të përdorë platformën, ai / ajo mund ta dërgojë aplikacionin në mënyrë elektronike përmes postës elektronike dhe të përfshijë të gjithë dokumentet e kërkuara si në rastin e aplikimit në internet.

KREU IV
ZHVILLIMI I KURSIT TË TRAJNIMIT PËR ZHVILLIM PROFESIONAL TË VAZHDUESHËM DHE CERTIFIKIMI

Neni 6
Zbatimi i kursit të trajnimit për zhvillim profesional të vazhdueshëm

1. Trajnimet do të organizohen bazuar në kurrikulat e Shkollës së Drejtorëve.
2. Trajnimi do të organizohet në vendet e përcaktuara nga Shkolla e Drejtorëve, duke marrë parasysh vendbanimin e pjesëmarrësve.

Adresa: Bulevardi "Zhan d'Ark", Nr. 23, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 220 9185 / E-mail: info@csl.edu.al / Web: www.csl.edu.al

3. Në raste të veçanta, trajnimi do të ofrohet në internet për pjesëmarrësit. (kur metodologjia e trajnimit ofrohet në internet, ose ka rrethana kur trajnimi në sallë nuk mund të zhvillohet.)
4. Trajnimet do të organizohen në bazë të datave të përcaktuara nga Shkolla e Drejtorëve. Pjesëmarrësit do të njoftohen nga stafi i Shkollës së Drejtorëve për kalendarin e trajnimeve.
5. Programi i trajnimit do të organizohet në orë kur nuk ka mësime për mësuesit dhe drejtuesit e shkollave dhe nuk do të ndikojë në orarin e punës së pjesëmarrësve (pa shkëputje nga puna).

Neni 7
Procesi i certifikimit të pjesëmarrësve të programit të trajnimit për zhvillim profesional të vazhdueshëm.

1. Pjesëmarrësit në kurset e trajnimit të programit për zhvillim profesional të vazhdueshëm duhet të jenë të pranishëm në 100% të orëve të trajnimit.
2. Nëse njëri nga pjesëmarrësit mungon në trajnim për arsye objektive mund të marrë pjesë në trajnimin tjetër që do të organizohet për atë temë, pa qenë e nevojshme të bëhet pagesa shtesë. Në këtë rast, aplikanti duhet të dërgojë një email për të njoftuar për mungesën dhe kërkesën për të vazhduar trajnimin në mundësinë e ardhshme të trajnimit. Këto raste duhet të jenë të kufizuara vetëm kur pjesëmarrësi mungon për shkak të një arsyeje shumë të fortë dhe nuk ka filluar ende programin e trajnimit.
3. Pjesëmarrësit e trajnimit duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat e trajnimit përfshirë pjesëmarrjen, orët e vetë-studimit dhe projektet të cilat përcaktohen nga trajnuesit në kurrikulat e trajnimit.
4. Pjesëmarrësit në program do të vlerësohen për performancën në trajnim bazuar në mjetet e verifikimit të përcaktuara nga trajnuesit në kurrikulat e trajnimit.
5. Stafi i Shkollës së Drejtorëve do të ndjekë procesin e akreditimit të pjesëmarrësve dhe do t'u sigurojë atyre çertifikatat.

KREU V
ASPEKTE FINANCIARE DHE TARIFAT

Neni 8
Çmimet e shërbimeve të trajnimit.

1. Çmimet e trajnimit përcaktohen nga Shkolla e Drejtorëve. Çmimet janë subjekt i ndryshimit në varësi të ndryshimeve në çmimet e tregut, dhe / ose kur Shkolla e Drejtorëve e konsideron të arsyeshme.
2. Ndryshimi i çmimeve të shërbimeve mund të bëhet vetëm përmes miratimit nga Bordi i Drejtorëve të Shkollës së Drejtorëve.

Adresa: Bulevardi "Zhan d'Ark", Nr. 23, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 220 9185 / E-mail: info@csl.edu.al / Web: www.csl.edu.al

3. Në raste specifike, Shkolla e Drejtorëve do tu ofrojë pjesëmarrësve bursa ose subvencione për tu përfshirë në trajnim duke përcaktuar kritere të qarta për personat që mund të përfitojnë (nevoja financiare e pjesëmarrësve, raste urgjente etj). Bursat do të shpallen përmes mjeteve të komunikimit të Shkollës së Drejtorëve dhe do të hapen për të gjithë ata që janë të interesuar. Kriteret dhe aplikimet për bursa do të vlerësohen nga një komision i Shkollës së Drejtorëve.

KREU VI
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 9
Dispozita të fundit dhe hyrja në fuqi

Ngarkohet Shkolla e Drejtorëve për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Bordi Drejtues i Shkollës së Drejtorëve.

Adresa: Bulevardi "Zhan d'Ark", Nr. 23, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 220 9185 / E-mail: info@csl.edu.al / Web: www.csl.edu.al

Shtojca:

TARIFAT E SHKOLLËS SË DREJTORËVE

Llojet e pagesave	Tarifa
Tarifa e programit për mësues	2000 lekë
Tarifa e programit për drejtorët dhe zv / drejtorët	2500 lekë
Pajisja me certifikatë	0

Adresa: Bulevardi "Zhan d'Ark", Nr. 23, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 220 9185 / E-mail: info@csl.edu.al / Web: www.csl.edu.al